



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**V E N D I M**

**Nr. 438, datë 19.07.2023**

**PËR**

**PEZULLIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR NR. 2/2023, TË FILLUAR NDAJ  
MAGJISTRATIT, Z. {...}, ME FUNKSION GJYQATAR PRANË GJYKATËS SË  
SHKALLËS SË PARË TË JURIDISKIONIT TË PËRGJITHSHËM KUKËS**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, më datë 19.07.2023, mori në shqyrtim kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor nr. 2/2023 që i përket:

**KËRKUES:** Inspektori i Lartë i Drejtësisë

**SUBJEKT I PROCEDIMIT:** Magjistrati {...},

**OBJEKTI I KËRKESËS:**

1. Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.
2. Propozimin për caktimin e masës disiplinore :  
- “Vërejtje publike”

**BAZA LIGJORE:** Neni 138; neni 101, pika 1, shkronja “b”; neni 102, pika 1, shkronja “c”; neni 107 i Ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Pas shqyrtimit të aktit mjekësor, vërtetim datë 13.07.2023 lëshuar nga KMCAJ i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër bazuar në vendimin nr. 452 datë 13.07.2023, të depozituar nga subjekti i procedimit në rrugë elektronike, mbështetur në nenin 116 pika 1 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 97, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3, i Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 44 të Kodit të Procedurës Penale, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

## **V E N D O S I:**

1. Pezullimin e procedimit disiplinor nr. 2/2023 të filluar ndaj magjistratit {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, për një periudhë kohe 1 (një) vit.
2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet subjektit të procedimit disiplinor, magjistratit z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**